



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 12769 Prot

Vlorë, më 12.08. 2024

PROJEKT VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ Datë, \_\_\_\_\_ 2024

**"PËR SHTYRJE TË AFATIT TË KONTRATËS PËR ADMINISTRIMIN DHE FINANCIMIN E SHOQËRISË FLAMURTARI FOOTBALL CLUB SH.A"**

Në bazë të Neneve 8.2, 9.1, 9.2, 25.4, 54, të Ligjit Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në Ligjin Nr 79/2017 "Për Sportin", Nenet 20, 33, 39 dhe në vijim , Ligji Nr 9901, datë 14.04.2028 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", Nenet 135 dhe 167, në Rregulloren "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë" Neni 94, Statutit dhe Aktit të Themelimit të Shoqërisë "Flamurtari Football Club Sh.A" Rregullorja dhe Statuti i Federatës Shqiptare të Futbollit, VKB Nr 39, datë 31.07.2014 "Për disa ndryshime në administrimin e Shoqërisë "Flamurtari Football Club Sh.A", në VKB Nr 38, datë 01.08.2016 "Për shtyrje të afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e Shoqërisë "Flamurtari Football Club Sh.A", VKB Nr 89 , datë 26.07.2018 "Për shtyrje të afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e Shoqërisë "Flamurtari Football Club Sh.A", në VKB Nr 64, date 14.08.2020 "Për shtyrje të afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e Shoqërisë "Flamurtari Football Club Sh.A ", VKB Nr 70, datë 31.08.2023 "Për shtyrje të afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e Shoqërisë "Flamurtari Football Club Sh.A", Marrëveshjes së financimit dhe administrimit të Shoqërisë "Flamurtari Football Club Sh.A, të lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe Shoqërive "TRK GROUP dhe ATLAS Global" me propozim të një grupi këshilltarësh , referuar shkresës Nr. 1149 Prot, datë 22.07.2024, të përfaqësuesit të Shoqërive "TRK GROUP dhe ATLAS Global", Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës .08.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë shtyrjen e afatit të kontratës së financimit dhe administrimit të Shoqërisë "Flamurtari Football Club Sh.A", të lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe Shoqërive "TRK GROUP dhe ATLAS Global", për një periudhë 1-vjeçare.

2. Pavarësisht përcaktimit në pikën 1, efektet e kontratës së financimit dhe administrimit të Shoqërisë “Flamurtari Football Club Sh.A”, përfundojnë me shitjen e aksioneve të kësaj shoqërie, aktualisht në pronësi të Bashkisë Vlorë.

3. Administrata e bashkisë të kryejë procedurat për shitjen e aksioneve të Shoqërisë “Flamurtari Football Club Sh.A” në pronësi të saj, si dhe për përcaktimin e Statutit Juridik të Ekipit të Futbollit “Flamurtari”.

4. Të miratohen emrat e Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, si më poshtë vijon:

- a) Sinan Idrizi
- b) Kreshnik Çipi
- c) Robert Islamaj
- d) Endri Hyseni (Përfaqësues nga Këshilli Bashkiak)

Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, është 1 vit.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore“, Neni 55, pika 6.

**Këshilltarët propozues :**


1.Grigor Dede

2.Endri Hyseni

3.Edison Kapaj

4.Bujar Osmanaj

5.Lorel Canaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 12769 prot.

Vlorë, më 12 08 2024

## RELACION

### Mbi projektvendimin "PËR SHTYRJE TË AFATIT TË KONTRATËS PËR ADMINISTRIMIN DHE FINANCIMIN E SHOQËRISË FLAMURTARI FOOTBALL CLUB SH.A"

Të nderuar Këshilltarë!

Me shkresën Nr.1148 datë 22.07.2024, administratori i shoqërive "TRK dhe Atlas Global", ka kërkuar nga Këshilli Bashkisë Vlorë shtyrjen e afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e Shoqërisë "Flamurtari Football Club Sh.A", në pronësi të Bashkisë Vlorë.

Kjo pasi sikurse jeni në dijeni, shoqëritë TRK dhe Atlas Global, në bazë të vendimeve të Këshillit Bashkiak Vlorë, kanë lidhur një marrëveshje për financimin dhe administrimin e shoqërisë "Flamurtari Football Club Sh.A", duke marrë përsipër financimin e të gjithë aktivitetit sportiv, i cili është objekt i veprimtarisë së kësaj shoqërie. Gjatë kësaj periudhe disavjeçare, financimi i aktivitetit të kësaj shoqërie është kryer prej shoqërive financuese, duke sjellë kursime në të ardhurat e Bashkisë Vlorë.

Ky bashkëpunim është realizuar bazuar në disa vendimmarrje të Këshillit të Bashkisë Vlorë, sikurse janë VKB nr.39 datë 31.07.2014 "Për disa ndryshime në administrimin e shoqërisë "Flamurtari Football Club Sh.A", apo VKB-të nr.38 datë 01.08.2016, VKB nr.89 datë 26.07.2018, VKB nr.64 datë 14.08.2020 "Për shtyrje të afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e shoqërisë "Flamurtari Football Club Sh.A", VKB nr.53 datë 26.08.2021 "Për shtyrje të afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e shoqërisë "Flamurtari Football Club Sh.A" si dhe VKB nr.70 datë 31.08.2023 "Për shtyrje të afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e shoqërisë "Flamurtari Football Club Sh.A".

Bazuar në Ligjin nr.79/2017 "Për Sportin", i ndryshuar me Ligjin nr. 105/2020 datë 29.07.2020, në nenin 22 përcaktohet se institucionet qendrore dhe vendore që kanë në zotërim aksionet e shoqërive tregtare sportive duhet ti nxjerrin në shitje brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e ligjit. Sikurse jeni në dijeni, gjithashtu Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 31 Gusht 2023, ka vendosur për shtyrjen e afatit të kontratës për një afat 1 vjeçar, si dhe vijimin e procedurave të tjera, për shkak se Bashkia Vlorë nuk i kishte kryer procedurat e nevojshme, në zbatim të ligjit, ligj ky, i cili ka hyrë në fuqi në datë 10.09.2020 (15 ditë pasi është botuar në fletoren zyrtare 154 datë 26.08.2020), me afat të caktuar të nxjerrjes në shitje të aksioneve, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e ligjit. Ky afat, sikurse cituam më lart, përfundonte në 10 Shtator 2021.

Bashkia Vlorë si zotëruese e aksioneve të shoqërisë “Flamurtari Football Club sh.a”, edhe pse ka nisur procedurat përkatëse, nuk ka arritur të kryejë shitjen e aksioneve që zotëron, dhe për pasojë, kjo shoqëri nuk ka marrë formën sipas përcaktimeve të nenit 21 të ligjit “Për Sportin”. Sipas këtij neni, kjo shoqëri duhet funksionojë sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse dhe shoqëritë tregtare, ose kthehet në klub sportiv.


Në përfundim dhe ndodhur përpara kësaj situatë faktike dhe ligjore, Grupi prej 5 (pesë) Këshilltarësh, është i mendimit, që të vazhdoj bashkëpunimi me shoqëritë “TRK GROUP dhe ATLAS Global” për financimin dhe administrimin e Shoqërisë “Flamurtari Football Club Sh.A” për një periudhë 1 vjeçare, duke qënë se jemi në prag të fillimit të sezonit futbollistik 2024-2025, pasi është e pamundur të bëhet regjistrimi në Federatën Shqiptare të Futbollit për të garuar në aktivitetet sportive të organizuara nga FSHF, afat i cili shpresojmë të japë kohën e nevojshme për kryerjen e procedurave të shitjes së aksioneve, apo formave të ndryshme të organizatave sportive që mund të përcaktohen nga legjislacioni shqiptar në vijim, si dhe të jepet mundësi për ringritjen e ekipit në vendin që i takon.

Në bazë të marrëveshjes së lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe shoqërive TRK GROUP + ATLAS Global, për mbikqyrjen e aktivitetit të shoqërisë si dhe pjesë e vendimmarrjes së saj, Këshilli Bashkiak duhet të ketë përfaqësuesin e tij në këshillin drejtues të shoqërisë ku kërkohet të rikonfirmohet Endri Hyseni, kurse 3 anëtarët e tjerë do të propozohen nga shoqëritë financuese, që në fakt kanë rikonfirmuar në detyrë 3 anëtarët e mëparshëm z.Sinan Idrizi, z.Kreshnik Çipi, z.Robert Islamaj.

Ndërkohë pavarësisht problematikave të konstatuara lidhur me procedurën e shitjes së aksioneve administrata e Bashkisë duhet të vijojë punën e nisur për ta përfunduar këtë proces. Përfundimisht, ju ftojme të miratoni këtë projektvendim me qëllim vazhdimin e procedurave të mëtejshme.

#### **GRUPI I KËSHILLITARË PROPOZUES**

- 1. GRIGOR DEDE**
- 2. EDISON KAPAJ**
- 3. ENDRI HYSENI**
- 4. BUJAR OSMANAJ**
- 5. LOREL CANAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 12772/ prot.

Vlorë, më 15.08 2024

Lënda: Shprehje mendimi mbi Projekt-Vendimin “Për shtyrje të kontratës për administrimin dhe financimin e shoqërisë “Flamurtari Football Club Sh.A”

**KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË** ✓

Të nderuar këshilltar!

Drejtorja Juridike e Bashkisë Vlorë pasi u njoh me materialin dhe propozimin e Kryetarit të Grupit të Këshilltarëve të Partisë Socialiste, në përputhje me nenin 94 pika 5 e Rregullores për funksionimin dhe organizimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë si dhe bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 25, pika 4; neni 54, pika d, e dhe pika k, konstaton se ky projektvendim nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe si i tillë duhet të merret në shqyrtim nga Këshilli i Bashkisë.

**DREJTOR**

**Dorian Demiri**

